



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 412, datë 04.10.2022

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z. {...} PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE
NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 697 prot., datë 30.09.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5154 prot., datë 03.10.2022, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me nr.59 akti, datë 08.09.2022 regjistrimi me të pandehur Aldo Nesimi etj.; akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR